



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 6138 Prot.

Fier, më 23.05.2025.

PROJEKT VENDIM
Nr. 47, datë 23.05.2025

PËR DHËNIE NDIHME SHTETËRORE FINANCIARE

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Xhoxhi Shqepa, lagjia "29 Nëntori", Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 22.04.2025.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", nenit 30 dhe 41 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", si dhe në zbatim të shkronjave "e" dhe "ë" të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 22.04.2025, shkresës zyrtare nr.475/1.prot, datë 09.05.2025 "*Vlerësim dëmi*" të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Xhoxhi Shqepa dëmi në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **140 000 (njëqind e dyzetë mijë) lekë** dhe në konstruksion banese në vlerën **39 716 (tridhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë**, ndaj bazuar në nenin 30, shkronja "gj", e ligjit 45/2019,

PROPOZON:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej Bashkisë Fier për shtetasin Xhoxhi Shqepa, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **140 000 (njëqind e dyzetë mijë) lekë**.
2. Dhënien e ndihmës prej Bashkisë Fier në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **19 858 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës "ç" "*Përcaktimi i ndihmës financiare*" e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale fianciare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Xhoxhi Shqepa është në masën **159 858 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile.

Drejtoria e Mbrojtjes Civile
Nasip BANI

Drejtoria Juridike
Esmeralda KAPLLANAJ

Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
Pranvera ÇINA

KRYETARI
Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËS KRYETAR

Vasil BREGU

